



K. R. U "Hidroregjioni jugor" SH. A, me seli në Prizren



Bordi i Drejtorëve i K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, në bazë të kërkesës së U.D Kryeshefit Ekzekutiv, bazuar në kompetencat e tij komfor nenit 7, paragrafi 2 i Statutit të K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, kërkesat që dalin nga Ligji Nr.06/L – 021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Neni 5 par. 1.2 i Rregullores QRK – NR 01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funkcionit të Auditimit të Brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik, Neni 17 par. 2 dhe 3 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, si dhe Neni 34 i Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2024, mori këtë:

VENDIM

1. **Miratohet** kërkesa e U.D Kryeshefit Ekzekutiv për plotësim të Rregullores Nr.735 e datës 20.03.2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës si dhe koeficientet e pagave për të gjitha pozitat e punës.
2. **Plotësohet** Rregullorja Nr.735 e datës 20.03.2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës si dhe koeficientet e pagave për të gjitha pozitat e punës, dhe shtohet pozita e punës "Auditor i Brendshëm" në K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh. A, Prizren.
3. Detyrat dhe përgjegjësit e Auditorit të Brendshëm janë në shtojcën e bashkëngjitur në këtë vendim, të cilat do të jenë pjesë përbërëse të Rregullores Nr.735 të datës 20.03.2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës si dhe koeficientet e pagave për të gjitha pozitat e punës në K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A, Prizren.
4. Koeficienti i pagës për Auditorin e Brendshëm do të jetë 3.
5. Ky vendim për plotësimin e Rregullores hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të K.R.U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A në Prizren.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve


Feim Fetoshi





KRU Hidroregjioni Jugor sh.a.

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren - Tel.: 029/ 244 150
e-mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

1. Emërtimi i vendit të punës: Auditor i Brendshëm

Përgatitja profesionale: Të ketë diplomë universitare në ekonomi, financa, kontabilitet, administratë publike, juridik apo të ngjashme

Përvoja e punës: Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e auditimit ose kontabilitetit, menaxhimit financiar;

Numri i kryesve: 1

Kushtet e veçanta: Të jetë auditor i brendshëm i çertifikuar sipas nenit 22 pika 2.2 të Ligji Nr.06/L-021, njohës i mirë i sistemit financiar, kontabël;

Të ketë njohuri nga fusha e qeverisjes korporative dhe financiare;

Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;

Nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale të dënueshme së paku gjashtë (6) muaj;

Shkathtësi të shkëlqyeshme për analizim dhe definim të problemeve, fakteve dhe për dhënie të rekomandimeve dhe konkluzioneve të bazuara në dëshmi;

Demonstrimi i aftësive të shkëlqyeshme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e Ndërmarrjes;

Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point);

Preferohet njohje e mirë e gjuhës angleze.

Koeficienti i pagës:

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Përgatitjen e planit për njësinë për auditim;
- Sigurimin e cilësisë së angazhimeve të auditimit;
- Përgatitjen e letrave të punës në lidhje me auditimin e kryer;
- Përpilimin dhe përgatitjen e nivelit të reziqeve të cilat duhet ti kryej gjatë auditimit;
- Dhënia e rekomandimeve adekuate për njësinë - departamentin e audituar;
- Kryerjen e auditimit të rregullsisë financiare, operative, ligjore, performances, percjelljes etj;
- I zbaton detyrat dhe përgjegjësit sipas planë programit dhe kërkesave shtesë të cilat mund të delegohen nga ZAB;
- Përgatitjen dhe adaptimin e pyetësorëve sipas aktivitetit audituese;
- Nxjerrjen e mostrimit sipas gjykimit profesional ose metodave tjera relevante;
- Mbledhjen dhe analizën e të dhënave;
- Mbajtjen e takimit përmbyllës të auditimit;
- Përgatitjen e draft raportit dhe raportit të auditimit;
- Përcjelljen e implementimit të rekomandimeve të dhëna;
- Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë të cilat kanë për qëllim që të sigurojnë se dokumentacioni financiar, ligjor mbahet në përputhje me standardet, rregullat dhe ligjet përkatëse;
- Verifikimi i përshtatshmërisë dhe funksionimit të rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat e kanë për qëllim që të garantojnë zbatimin e ligjeve të aplikueshme në Kosovë;
- Të raportoj për aktivitetet audituese tek Zyrtari për Auditim të Brendshëm;
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Zyrtari i Auditimit të Brendshëm.
- Për punën që kryen i përgjigjet Zyrtari i Auditimit të Brendshëm dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

